



**AUTO CLUB
ALBANIA**

Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,
E: info@aca.al /W: www.aca.al

Datë: 22/06/2021

Nr. 23 Prot.

Drejtuar: Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës

Për dijeni: Komisarariatit të Policisë Krujë

Subjekti: Kërkesë për mbështetje për organizimin e garës sportive ndërkombëtare me autovetura "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021"

Të nderuar Zotërinj,

Klubi i Automobilit të Shqipërisë (ACA), me autoritetin e Federatës Shqiptare të Sporteve të Automobilizimit (FASA), do të organizojë në datat 11 Shtator - 12 Shtator 2021, aktivitetin e garës sportive ndërkombëtare të shpejtësisë me autovetura, "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021". Ky është viti i 8-të që kjo garë ndërkombëtare zhvillohet në territorin e Bashkisë Krujë.

"Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" është garë sportive me autovetura e regjistruar zyrtarisht në Kalendarin Kombëtar Sportiv të FASA e cila ka të drejtën e organizimit të saj.

Kjo garë është gjithashtu e regjistruar dhe është e vlefshme për kampionatin e Federatës Ndërkombëtare të Automobilizimit (FIA www.fia.com) për Zonën e Europës Qëndrore (CEZ-FIA <http://www.cez-motorsport.com/2021/cez-hill-climb/>). Në garë do të marrin pjesë mbi 30 garues nga Shqipëria, Italia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Polonia, Sllovenia, Kroacia, etj. Klubi ACA dhe Federata FASA, për 7 vjet, organizojnë garën sportive ndërkombëtare në territorin e Bashkisë Krujë në Rugën e Malit, në segmentin rrugor Mali i Krujës - Sarisalltik.

Aktiviteti sportiv automobilistik do të zhvillohet në dy ditë:

- datë 11 Shtator 2021, ditën e shtunë, ora 08:30 deri në orën 14:00, do të zhvillohet sesioni i provave zyrtare;
- datë 12 Shtator 2021, ditën e dielë, nga ora 09:00 deri në orën 15:00 do të zhvillohet sesioni i garave.

Për sa më sipër, me anë të kësaj shkrese kërkojmë mbështetjen Tuaj dhe të institucionit që Ju drejtoni në organizimin e këtij eventi, sipas të gjithë procedurave përkatëse. Paraprakisht, po Ju konfirmojmë se i jemi drejtuar për mbështetje dhe kemi vënë në dijeni Bashkinë e Krujës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, shërbimin e zjarrfikëseve dhe shërbimin e domosdoshëm mjekësor.

Gjej rastin të shpreh vlerësimin e Klubit ACA dhe Federatës FASA për kontributin e dhënë nga institucioni juaj në zhvillimin e edicioneve të mëparshme të kësaj gare, dhe të shpreh bindjen që do të gjejmë sërish mbështetjen Tuaj për mbarëvajtjen e aktivitetit edhe këtë vit.

Duke ju falënderuar paraprakisht për kohën Tuaj, mbetemi në dispozicionin për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratat më të mira,

Eridon Lameborshi

Eridon LAMEBORSHI
Sekretar i Përgjithshëm
Auto Club Albania



MEMBER OF

